



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për transferimin e mjeteve nga mbetjet e projektit kapital të tenderuar të DSHMS-së

Neni 1

Nga mjetet e lira të projektit kapital “Rëntgeni” 83141 programi 730 – Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nënprogrami Shërbimet e Shëndetësisë Primare (74450), shuma fillestare e projektit 79,949.00 €. Prandaj shuma e mjeteve të mbetura dhe të lira të ridestinohet nga fondi burimor 10, në vlerë prej 21.199.00 € të kalojë në projektin kapital të ri (pajisje për Oksigjenim të QKMF-së) në drejtorinë, nënprogramin dhe vlerën e njëjtë (në shumën prej 21.199.00 €), gjithashtu në fondin dhjetë (10).

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

V E N D I M

Për transferin e mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Me këtë vendim do të bëhet harmonizimi i mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nëpër të gjitha programet buxhetore.

Neni 2

Nga programet që kanë mjete të lira në kategorinë e pagave dhe mëditjeve të mbulohet minusi (mungesat) në programet tjera (në mungesë të mjeteve buxhetore).

Neni 3

Mjetet e mbetura të lira nga kjo kategori në shumë prej 52,774.00€, të transferohen në kategorinë mallra dhe shërbime në Drejtorinë Shërbime Publike, me qëllim të pagesës së obligimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat kanë mbet të papaguara .

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 12.2”d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-04, nenit 5 “a” i Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës 03/L-068 dhe në bazë marrëveshjes në mes të CDF-së dhe Kryetarit të Komunës 02.Nr. 813 -03- të datës 06.09.2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim lejohet barta e mjeteve të lira:

- a) Nga mjetet e lira të projektit kapital “Ndërtimi i shkollës fillore në Zhilivodë” me shumën 1,333.96 €.
- b) Nga mjetet e lira të projektit kapital “Ndërtimi i shkollës fillore në Bukosh” me shumën 19,696.12 €.
- c) Nga mjetet e lira të projektit kapital “Furnizimi i shkollës së muzikës me mjete muzikore” me shumën 2,232.00 €.
- d) Nga mjetet e lira të projektit kapital “Renovimi i shkollave” me shumën 137.92 €.
- e) Shuma e mjeteve të lira prej 23.400 € të barten në projektin e ri “Renovimi i shkollës fillore në Samadrexhë”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për caktimin e ditës festive “Dita e Patates” për Komunën e Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për caktimin e ditës festive “Dita e Patates” për Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DEBZH-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të propozim-vendimit në seancën e radhës së KK-së.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit për Komunën e Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit për Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DUMM-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit në seancën e radhës së KK-së.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DEBZH-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në seancën e radhës së KK-së.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 30 dhe 31 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26, të datës 24.06.2005, nenit 5 dhe 6 të Ligjit për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Pa luajtshme të Komunës nr.03/L-226 të datës 28.10.2010, nenit 14 dhe 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040; nenit 40.2" k" të Statutit të Komunës- Kuvendi i komunës në Seancën e vet të mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së pa luajtshme të komunës – tokës bujqësore dhe kullotat

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia me qira e të gjithë tokës bujqësore dhe kullotave në pronësi të Komunës së Vushtrrisë të konstatuara nga organet gjegjëse.

Neni 2

Patundshmëritë e evidentuara deri më tani por edhe ndonjë parcelë që mund të evidentohet në të ardhmen dhe që janë të shënuara me kulturë toka bujqësore dhe kullota të epen me qira në afat kohor një deri në tri vite me mundësi vazhdimi.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim do të rregullohen me kontratë të veçantë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Obliqohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim si dhe Drejtoria e Prokurimit Publik që t'i zbatojnë të gjitha procedurat e nevojshme Ligjore për dhënien me qira të ngastrave kadastrale-ngastrave bujqësore dhe kullotave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-04, nenit 22.1 “a,b” të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nr. 2002/19, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim lejohet sigurimi i mjeteve për pagesën e transportimit të nxënësve të këtyre shkollave:

- a) Nxënësit e fshatit Kollë që udhëtojnë në SHFMU “28 Nëntori” në Vërnice me shumë 1.920 €.
- b) Nxënësit e fshatit Kollë që udhëtojnë në SHFMU “Emin Duraku ” në Novolan me shumë 1.826 €.
- c) Nxënësit e fshatit Gumnishtë dhe Karaçë që udhëtojnë në SHFMU “A.Z..Cajupi” në Vushtrri me shumë 1.896 €.
- ç) Nxënësit e fshatit Mihaliq (lagjja Zenuni, Hajdari, Gela) që udhëtojnë në SHFMU “Abdyl Frashëri “ në Druar dhe Mihaliq me shumë 1.440 €.
- d) Nxënësit e fshatit Liqej që udhëtojnë në SHFMU “Gj.K. Skenderbeu” në Pantinë me shumë 1.222 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Arsim, Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorja për Prokurim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-04, nenit 22.1 “a,b” të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nr. 2002/19, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim lejohet sigurimi i mjeteve për transportimin e nxënësve të këtyre shkollave:

- a. Nxënësit e paraleles së ndarë në Zhilivodë deri te fshati Bivolak, lagjja “Berisha”.
- b. Nxënësit nga lagjet “Manova dhe Zymberi” në shkollën “Azem Bejta”.
- c. Nxënësit nga lagjja “Sfarçaliu” në shkollën “A.Z. Çajupi”.

Neni 2

Transportimi i nxënësve sipas nenit 1, pika “a”, e këtij vendimi bëhet deri sa të përfundojë ndërtimin e objektit – shkollës në Zhilivodë.

Neni 3

Shuma totale është 1.400 € për një muaj, për transportimin e nxënësve sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-04, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011 mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim aprovet Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve publike në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Grupi punues për ngritje të performancës në shërbime publike.

Neni 3

Në shtojcë të këtij vendimi bashkëngjitet Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve publike.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi